



HAPI I PESTË

(Përfundimi i marrëveshjes për qiradhënie)

Ju apo bartësi i së drejtës pronësore mund të vendosë për tërheqjen nga marrëveshja mbi qiranë kurdoqoftë, me kusht që njoftimi të bëhet 2 muaj më herët, duke filluar nga dita e parë e muajit vijues. Për shembull: nëse ju apo bartësi i së drejtës pronësore e njoftoni (me shkrim) KPA-në më 12 prill, të drejtat dhe obligimet tuaja vlejnë deri më 30 qershor.

Skadimi i zakonshëm i marrëveshjes mbi qiranë: Me përfundimin e periudhës së kontratës (1 vjeçare) do t'ju ofrohet kontratë e re 1 vjeçare, me kusht që bartësi i së drejtës pronësore të mos ketë kërkuar riposëdimitin e pronës kurse ju të keni përmbushur obligimet në pajtim me marrëveshjen mbi qiranë.

Rekomandojmë që të ruani fletëpagesat dhe kontratën e nënshkruar deri dy muaj pas largimit nga prona.

Beograd

Kosovska 49/8

Tel: 011 334 5513 ose 334 5314 Fax: 011 334 4452

Gjilan

Rade Popovic/Washington Street

Tel: 0280 320 289 - fax: 0280 324 067

Kragujevc

9, "Llolla Ribar" Rr. Kati 3të

Tel: 034 330-234; 330-784

Mitrovicë

Pjesa jugore: rr. Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës)
028 530 136 and 530 137 - fax: 028 530 139

Pjesa Veriore: rr. Filip Vishnjq No. 4, Dhoma No. 18 (ish Ndërtesa e AKM), Stacioni Verior i Policisë

Tel: 063 197 6470 - fax: 028 530 139

Nish

rr. "Dusanov Bazar" (Dusanova) Kati 3të, Zyrja No. 308

Tel: 018 515-727; 515-728

Pejë

rr. Mbretëresha Teuta, Nr. 85

Tel: 039 431 668, 039 432 968

fax: 039 432 970

Podgoricë

Crnogorskih Serdara

Tel: 081 624 216

Prishtinë

Qendër: Rexhep Luci 28/rr. Goleshit 2 Tel: 038 225 473 -

fax: 038 244 854 Graçanicë: Prapa ndërtesës së komunës

Tel: 038 225 473

Prizren

Jeronim Derada (ish Zef Mark Lushi/Metohisë) No. 63/A

Tel: 038 504 604 8046/8024 - fax: 029 631 429

Shkup

rr. Vinička No. 10 (ndërtesa CDRIM),
kati i 1rë

Tel: +389 22 656 291



mailbox@kpaonline.org



Agjencia Kosovare e Pronës



A po kërkon **shtëpi** apo
banesë me **qira**?

KPA-ja ju ofron mundësi
të volitshme **banimi** në
tërë **Kosovën**.

www.kpaonline.org

BËHUNI QIRAMARRËS I KPA-së me 5 HAPA!

Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) ka iniciuar skemën e qiradhënies për rreth 5000 prona, që janë nën administrimin e saj. Skema e Qiradhënies e KPA-së ofron me qira banesa dhe shtëpi të volitshme në krejt Kosovën.

1

HAPI I PARË

(Si të bëheni qiramarrës i pronës nën administrimin e KPA-së)?

Është fare e lehtë që të bëheni një qiramarrës. Nëse jeni duke kërkuar një pronë banimi me qira në Kosovë, ju duhet të caktoni një vizitë në njërin prej zyreve tona (shih listën e adresave në pjesën e prapme të kësaj fletë-palosjeje), dhe në asnjë mënyrë mos harroni se duhet të sjellni me vete; një dokument identifikimi, të dhënat personale për kontaktim, (adresa aktuale, numri i telefonit, e preferueshme edhe një email adresë), si dhe informacionet tuaja bankare. Zyrtarë të KPA-së do t'ju ndihmojnë me informatat e nevojshme se si mund të merrni me qira një pronë brenda Skemës së qiradhënies së KPA-së.

2

HAPI I DYTË

(Zgjedhja e pronës dhe hyrja në marrëveshjen e qiradhënies.)

Skema e qiradhënies së KPA-së ka apartamente dhe shtëpi për qira në tërë Kosovën. Pasi ju të keni zgjedhur pronën e mundshme, KPA do t'lidh një marrëveshje qiradhënie me ju si qiramarrës. Marrëveshja për qira do të jetë për 1 vit me mundësi vazhdimi edhe për 1 vit tjetër.

KPA-ja, jep me qira pronën në emër të bartësit të së drejtës pronësore, i cili është përcaktuar që të vendos pronën e tij/saj nën administrimin e KPA-së.

Prona merret "ashtu siç është" (fotografitë mund të jenë por edhe të mos jenë të sakta). KPA dhe bartësi i së drejtës pronësore nuk do t'ju mundësojnë ndonjë shërbim qiradhënës, pagesën e dëmeve ose rregullimin e pronës. Po ashtu, ju nuk do të kompensoheni për ndonjë riparim të bërë në pronë.

3

HAPI I TRETË

(Çmimet dhe pagesat)

KPA përcakton vlerën e qirasë, bazuar në vlerën aktuale të pronës, ashtu siç edhe është përcaktuar nga autoritetet komunale. Qiraja mirret nga KPA-ja në baza mujore.

Çmimet janë konkurrese me tregun e qirasë.

Në momentin e hyrjes në marrëveshjen e qiradhënies, ju duhet të paguani qiranë e muajit në të cilin hyni, plus një depozit (për 2 muaj qira). Ky depozit do t'ju kthehet juve më rastin e përfundimit të periudhës së qirasë, me kusht që të keni paguar me rregull qiranë mujore si dhe të gjitha shpenzimet tjera komunale relevante dhe me kusht që nuk jeni përgjegjës për çfarëdo dëmi ndaj pronës gjatë marrëveshjes mbi qiranë.

Nëse dështoni të paguani qiranë në përputhshmëri me marrëveshjen mbi qiranë, KPA-ja do të iniciojë procesin e dëbimit.

4

HAPI I KATËRT

(Marrja e çelsave)

Pasi ju ta keni zgjedhur pronën, dhe pasi ta keni dëshmuar pagesën për muajin e parë (përfshirë edhe depozitimin), ju do t'i merrni çelsat e pronës.

